



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Buletini Mujor

Korrik 2022



MBËSHTETJA NDAJ EKOSISTEMIT TË STARTUP-EVE, SHPALLEN FITUESIT E THIRRJES SË PARË TË KATEGORIVE STARTUP DHE LEHTËSUES

Janë shpallur fituesit e Thirrjes së Parë për mbështetje me grant për startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve. Në këtë kuadër, është zhvilluar edhe takimi i parë prezantues për të dy kategoritë.



Thirrja e parë publike me fonde nga buxheti i shtetit është hapur më 16 Maj 2022, teksa pas një pune intensive dy-mujore është shpallur edhe lista e fituesve për të dyja kategoritë më 15 Korrik 2022. Në kategorinë Startup janë **23 fitues**: 2 aplikime fituese në fazën fillestare, 5 aplikime fituese në fazën e rritjes dhe 16 aplikime fituese në fazën e zgjerimit. Ndërsa në kategorinë e lehtësuesve të shpërndarë në të gjithë vendin, janë shpallur fitues: 7 bashki, 4 universitete, 1 shkollë e mesme profesionale, 15 inkubatorë/akseleratorë dhe 2 organizues eventesh.

Vlen të theksohet edhe shpërndarja e larmishme e fituesve me **50% nën moshën 30 vjeç**, si dhe një total prej **45% gra** dhe vajza. Ndërkategoritë ku kanë dominuar aplikimet janë **TIK, Fintech, Robotika, Prodhimi, Transporti, Inxhinieria** dhe **Kultura**.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Buletini Mujor

Korrik 2022



VIJOJNË PA NDËRPRERJE PRITJET E INVESTITORËVE TË HUAJ

Në kuadër të rritjes së investimeve të huaja në vend, Ministria Edona Bilali ka mikpritur një delegacion të bizneseve qindra vjeçare nga Anglia dhe Hong Kongu.

Interesit të tyre për të investuar në fushat e infrastrukturës, energjisë, ndërtimit, financës dhe prodhimit, Ministria Bilali i është përgjigjur duke ofruar mbështetjen e plotë të institucionit që ajo drejtton dhe të qeverisë shqiptare, si dhe duke pasqyruar paketën e gjerë të lehtësimeve për investim në Shqipëri. Në takim, investorët e huaj janë takuar edhe me përfaqësues të lartë të nivelit qendror e vendor përfaqësues të fushave të interesit të shprehur prej tyre në mënyrë që të konkretizohen hapat e bashkëpunimit në fusha më interes të ndërsjellë.



MINISTRI I SHTETIT PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES, MBËSHTETJE NDAJ SHQIPTARËVE TË DIASPORËS

Në një takim "online" me përfaqësues të bizneseve të diasporës shqiptare, Ministria Edona Bilali ka nën vizuar mbështetjen ndaj diasporës shqiptare për të investuar në vendin amë.

Përgjatë këtij takimi, u diskutua rreth strategjisë së Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare mbi rrjetëzimin, zhvillimin e biznesit shqiptar në Diasporë, prurjen e investimeve nga Diaspora, promovimin e tyre, si dhe shkëmbimin e informacionit, duke përfshirë gjithashtu të dhëna statistikore, studime dhe analiza, të cilat u vijnë në ndihmë politikëbërjes me iniciativa të matshme dhe efektive.

Përveç të tjera, theksi u vendos edhe bashkërendimi i aktiviteteve të përbashkëta në të ardhmen e afërt mes Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare, për të rritur kësijo edhe investimet nga ana e diasporës në Shqipëri.



ME DELEGACIONIN ITALIAN DISKUTOHET KLIMA FAVORIZUESE E ZHVILLIMIT TË BIZNESIT NË SHQIPËRI DHE MBËSHTETJA NDAJ EKOSISTEMIT TË STARTUP-EVE

Italia ngelet një mbështetëse e kahershme e Shqipërisë për rrugëtimin e saj evropian, si dhe një vend me investorë seriozë dhe me potenciale të pandalshme investimi në vendin tonë.

Në këtë drejtim, Ministria Bilali mirëpriti një delegacion të kryesuar nga deputetë dhe përfaqësues të Parlamentit Italian, Këshillit të Evropës etj., ku prezantoi klimën e favorshme për investim që Shqipëria ofron për biznesin e huaj.

Ndër të tjera, pjesë e diskutimit ishin edhe Ligji i Startup-eve, mbështetja e Qeverisë Shqiptare ndaj ekosistemit, paralelizmi me kuadrin ligjor italian dhe avantazhet e shumta që ofron shteti ynë në këtë sektor.